

Aktrimi, thirrje e fatit...

■ Filmi 'Koha e kometës' tuboi kombëtaren e aktorëve nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia. Ndërkaq, rolin kryesor të filmit, atë të Shestanit, e luajti aktori i ri Blerim Destani dhe çdo gjë gjatë xhirimit, siç thotë, u zhvillua në nivelin më të mirë. Mirëpo, kush është aktori Destani, çfarë është karriera e tij prej aktori, ku jeton... mësojmë nga intervista e zhvilluar për TEUTËN.

Intervistoi **Blinera Gashi**
Fotografite **Fadil Berisha**

Blerim, fillimisht të njihemi pak më shumë: prej nga jeni, cila është familja juaj?

▲ Jam tetovar, i lindur në Gjermani, dhe vazhdoj të jetoj në Gjermani, por Tetovën e ndiej si vendlindjen time, pasi aty i kam rrënjët e familjes. Njeriu jeton atje ku edhe punon, ndryshe nuk mund të jetë produktiv. Kështu që unë jetoj në Gjermani, në Maqedoni, në Kosovë, në Shqipëri, në SHBA... Në të ardhmen do të shohim se ku do të punoj.

▼ Ju jeni një aktor i ri. Si u bë që të kishit rolin kryesor në filmin 'Koha e kometës', e kujt ishte ideja?

▲ Që në leximin e parë të skenarit "Koha e kometës" pata një komunikim të fuqishëm me personazhin e SHESTANIT. Më pas deshi fati dhe gjërat lëvizën drejt asaj që edhe të realizoja këtë rol, që të futesha mirëfilli në lëkurën e këtij personazhi. Kuptohet, duhej shumë punë dhe përkushtim, pasi fjala ishte për një film shumë kompleks dhe me kërkesa të mëdha. Kompania ime LARA Enterprises, që e prodhoi filmin, caktoi prioritetet e saj bazuar në këtë skenar dhe çdo gjë u bë ashtu siç ishte planifikuar. Sa i përket rolit të Shestanit, unë e ndjeva që është rol i vështirë dhe se mua, përveç entuziazmit dhe vullnetit për punë, më mungonte përvoja. Kështu, angazhuam mikun tim, Refet

Abazin, i cili, përveç që bëri përzgjedhjen e aktorëve për film, punoi me mua si "couch" personal për përgatitjen e rolit. Me Refetin krijuam një sistem pune shumë produktiv, punuam gati gjashtë muaj dhe unë arrita që ta afroja Shestanin tek unë, dhe unë t'i afrohesha Shestanit.

▼ Në film kishte mjaft aktorë profesionistë nga Kosova dhe Shqipëria, si u ndiet në mesin e tyre?

▲ Ky ishte edhe njëri nga prioritetet tona, të tubonim aktorë jo vetëm nga Kosova dhe Shqipëria, por edhe nga Maqedonia. Ishte kjo një ide imja që të krijonim, në njëfarë mënyre, një kombëtare tonën të aktorëve, që do të tuboheshin rreth një projekti të këtillë. Unë, në mesin e kolegëve nga Shqipëria dhe

Kosova ashtu si edhe në mesin e kolegëve nga Maqedonia, u ndjeva shumë mirë. Arritëm të krijojmë një mënyrë komunikimi që ishte frytdhënëse gjatë gjithë procesit të punës.

▼ Në cilat vende është bërë xhirimi?

▲ Filmi është xhiruar në Maqedoni dhe në Shqipëri. Për xhirimin në Maqedoni vendosëm për shkak të lokacioneve shumë të bukura si dhe për shkak të shërbimeve të produksionit që na u ofruan. Gjithçka ishte në nivelin më të mirë të mundshëm.

▼ Cili ishte momenti më i vështirë për ju gjatë xhirimit të filmit?

▲ Kishte shumë momente të tilla. Por, do të kisha përmendur ditën e fundit të

xhirimeve. Të gjithë në mendje kishim festën që do ta bënim atë mbrëmje, me përfundimin e xhirimeve, dhe ajo ndjenjë gjatë ditës së fundit na u shndërrua në një pikëllim të çuditshëm. Gjatë gjithë asaj dite, i gjithë ekipi e ndjeu se ajo ishte e fundit e këtij bashkëpunimi, dhe që nga dita e nesërme të gjithë do të shpërndahehim. Edhe unë e ndjeva atë vështirësi, pasi një ekip prej afro 500 personave që kishim punuar bashkë në realizimin e filmit 'Koha e kometës', prej ditës së nesërme do të shpërndahej...

▼A mendoni se filmi 'Koha e kometës' ka arritur suksesin e pritur?

▲ Po. Plotësisht. Në film u realizuan pothuajse të gjitha prioritetet e parapara. Dhe do të thosha që edhe pritja shumë e mirë nga ana e publikut këtë e dëshmoi.

▼ Ju lutem, mund të thoni se në sa kinema dhe në cilat qytete është shfaqur ky film, dhe cilët adhurues kanë qenë më të entuziazmuar?

▲ Filmi është shfaqur në disa qytete dhe në shumë kinema. Ajo që vlen të theksohet është se sukcesi më i madh i filmit ka qenë pikërisht komunikimi me publikun. Kështu që në Prishtinë filmi i theu të gjitha rekordet e shikueshmërisë. Ndërsa tani filmi vazhdon jetën e vet duke u prezantuar nëpër festivale ndërkombëtare.

▼Aktorët duhet t'i përshtaten rolit edhe në pikëpamje fizike. Juve a ju është nevojitur një ndërhyrje e tillë: të dobësoheni, të lëshoni mjekër, t'i zgjatni flokët, apo të ndryshoni në ndonjë pikëpamje tjetër?

▲ Gjatë punës përgatitore për rolin erdhëm në përfundim që unë nga ana e jashtme duhej t'i afrohesha Shehanit, ndërsa nga ana shpirtërore duhej të

Blerim Destani:
Gjithçka që bëj në jetë është përvojë shumë e mirëseardhur për mua.

më afrohej mua. Kështu që unë, ndryshe nga look-u im, i zgjata flokët, shtova pak peshën e trupit dhe lëshova mjekrën.

▼ **Si u ndiet, kur e shikuat filmin për herë të parë: I privilegjuar, apo i bëtë kritikë vetes?**

▲ U ndjeva shumë i emocionuar. Është takimi me veprën që ti e ke punuar, në premierë ajo do të shihet për të parën herë nga ata të cilëve u dedikohet. Kjo është vërtet shumë emocionuese. Unë jam vetëkritik në raport me punën time, ky është një proces që zhvillohet thellë në mua, ku mundohem të nxjerr mësimet e duhura nga puna e bërë, për të ardhmen.

▼ **Akrimi është hobi, apo profesion juaji? Ku jeni shkolluar?**

▲ Gjithçka që bëj në jetë është përvojë shumë e mirëseardhur për mua. Ndërsa aktrimi është mbi të gjitha, aktrimi është një pasion imi i madh. Të gjitha punët e tjera që i kam bërë dhe i bëj, asnjëherë nuk ma kanë zbehur pasionin tim për aktrimin. Aktrimi për mua është disi si thirrje e fatit, dhe me shumë dashuri i përgjigjem kësaj thirrjeje. Kam mbaruar shkollimin për mjeshtërinë e aktorit në Këln, si dhe kam qenë në disa

trajtime edhe në Londër.

▼ **Ju jeni në fillim të karrierës suaj, synoni të zhvilloheni si aktor? Cila është maja që dëshironi të arrini?**

▲ Jam i kënaqur me projektet që kam realizuar, pasi karriera ime po ecën në një rrugë shumë të mirë dhe është në ngritje e sipër. Suksesi i “Koha e kometës” dhe i rolit të Shestaniit, më ka hapur dyert e disa projekteve ndërkombëtare. Kjo është një gjë që secili aktor do ta kishte dëshiruar. Duhet të cek se pikërisht ky rol m’i hapi dyert edhe për dy projekte të tjera ndërkombëtare: “Truth About Men” dhe “At World’s End”. Në fund të janarit do të shkoj në SHBA për xhirimet e filmit “Get low”. Kjo është ajo që momentalisht kam para vetes si realizime që më presin.

▼ **Cilët janë filmat tuaj të tjerë? Në sa filma keni aktruar?**

▲ Para “Koha e kometës” kam luajtur në “Metropol” dhe “Etjet e Kosovës”, ndërsa vitin e kaluar luajta në dy projekte ndërkombëtare, siç thashë, në filmin “Truth About Men”, që është në produksion të “New Holland Pictures”, autor i skenarit është Tom Scott, ndërsa regjisor Paul Middleditch, luajta rolin e një dirigjenti, përkrah aktorëve

Rhona Mitra, Thomas Kretschmann dhe Joel Edgerton. Ndërsa në filmin “At World’s End” luajta një rol të një Kameramani gjerman (Rudy Huber). Fjala është për një film të zhanrit triler/aksion, përplot me skena aksioni si dhe me shumë efekte speciale.

▼ **Shumë aktorë kanë idhujt e filmit. Cili është aktori juaj i preferuar?**

▲ Secili aktor i ri para vetes ka disa aktorë që i ka “idol”, punën e të cilëve e ndjek, ashtu edhe unë. Në orientimin tim për këtë profesion kanë ndikuar shumë Marlon Brando e Bekim Fehmiu dhe filmat e tyre. Këto dy figura përherë janë të pranishme brenda meje si udhërrëfyes dhe u jam shumë mirënjohës për veprat e tyre me të cilat jam rritur. Ndërsa prej aktorëve me të cilët do të kisha dashur të luaja bashkë është Sean Penn.

▼ **Në fotografitë e bëra nga Fadil Berisha, ju i ngjani Luke Perry-t, e pëlqeni këtë aktor amerikan?**

▲ Ndoshta është vetëm përshtypja juaj. Për këtë duhet ta pyesim edhe Fadil Berishën, të cilin e respektoj shumë si artist, ngaqë ai arrin që të spikasë diçka nga fytyra e personit që gjendet para kamerës së tij. Ai vërtet, nëpërmjet fotografive, arrin që të

spikasë edhe bukurinë shpirtërore. Dhe ndoshta është pikërisht merita e Fadil Berishës që unë ju kam përngjarë si Luke Perry?! Unë asnjëherë nuk kam tentuar që t’i përngjas dikujt, e aq më pak nga pamja fizike. Kam ndërtuar imazhin tim dhe kujdesem që këtë imazh ta përplotësoj me secilin rol që luaj.

▼ **Për çka do ta mbani mend periudhën e xhirimit, në filmin Koha e kometës?**

▲ Gjatë xhirimit pothuajse gjithçka ishte e veçantë. Një film të përmasave të “Koha e kometës” arritëm ta xhirojmë për 38 ditë. Kjo u arrit falë përkushtimit të gjithë ekipit të filmit.

▼ **Ju jetoni në Gjermani, a mendoni se ky vend ofron mjaft sa i përket filmit? Ndoshta Amerika ofron më shumë për aktorët, si mendoni?**

▲ Gjermania ofron mjaft sa i përket kinematografisë. Por, kuptohet, Holivudi është ëndërr për secilin aktor dhe kuptohet që do të dëshiroja të imponohesha atje si aktor. Mirëpo, ajo që mua më së shumti më intereson është që atje të vjel përvojën që më nevojitet, që në të ardhmen me kompaninë time të mundohemi të gjejmë një vend në atë nënqiell. Unë do të kisha dashur për fillim të sjell sado pak nga ajo industri e kinematografisë në kompaninë time LARA Enterprises. Është një domosdoshmëri për secilin që mendon seriozisht të merret me këtë punë, të mundohet të jetë pjesë e atij rrjeti të madh të industrisë kinematografike. ▼ **Na tregoni më gjerësisht për kompaninë tuaj LARA?**

▲ LARA Enterprises është kompani që është e pranishme në tregun gjerman. Prodhon filma, të cilët tashmë janë të njohur dhe janë bërë letërnjoftim i saj. LARA menaxhon disa aktorë,

‘Koha e kometës’, film kompleks, me kërkesa të mëdha



modele, sportistë si dhe disa spektakle televizive, që janë prezente në kanalet televizive gjermane. Në projektet që kemi realizuar kemi arritur të krijojmë një rrjet të kënaqshëm me shumë kompani ndërkombëtare, shpresoj se së shpejti e gjithë kjo do të rezultojë me një projekt ndërkombëtar.

▼ **T'i kthehemi jetës së përditshme. Çka ju pëlqen nga trendet aktuale?**

▲ Më pëlqen që trendet në mënyrë ciklike po ndërrohen. Ajo që para dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjetësh ishte trend, e që më pas doli nga trendi, tani përsëri është kthyer. Kuptohet, paksa e plotësuar nga konteksti kohor i sotëm. Mua tani më pëlqejnë veturat që nga pamja janë modele të vjetra, pra ato që ishin në trend para pesëmbëdhjetë vjetëve. Kuptohet, modeli, ana e jashtme është klasike, ndërsa enterieri dhe motori janë fjalë e fundit e teknikës. Më pëlqen kjo mënyrë e ndërlidhjes mes klasikes dhe modernes.

▼ **Në gardërobën tuaj a keni veshje të disenjatorëve botërorë?**

▲ Unë i pëlqej gjërat e bukura dhe me vlerë. Shumica e disenjatorëve të njohur botërorë disenojnë gjëra të bukura, dhe, natyrisht, disa nga ato gjëra të bukura dhe me vlerë janë pjesë e gardërobës sime.

▼ **A ju pëlqen jeta e natës dhe si zhvillohet ajo në Dyseldorf (në qytetin ku jetoni)?**

▲ Jo vetëm jeta e natës, në Dyseldorf më pëlqejnë shumë gjëra. Jam anëtar i disa klubeve VIP të qytetit, ndërsa tani, me ligjin për ndalimin e duhanit, jam anëtarësuar edhe në disa nga klubet "hous of cigars" më në zë të qytetit. Në Dyseldorf, në varësi nga disponimi që ke, mund edhe ta gjesht lokalin ku do të shkosh dhe mund ta

vazhdosh disponimin tënd. Kuptohet që shumica e takimeve profesionale realizohen pikërisht në këto klube. Zakonisht, secili klub ka edhe mysafirët e vet specialë që e frekuentojnë. Çdoherë kur dëgjohem me mikun tim, Ralf Mulerin, dhe kur e caktoj më takimin, ne e caktojmë vetëm orën, pasi vendi dihet. Është, pra, klubi ynë i preferuar "hous of cigars".

▼ **Me çka merreni atje, përveç aktrimit?**

▲ Jam aktor dhe producent. Që do të thotë merrem me të gjitha dimensionet e kinematografisë dhe të show biznesit.

▼ **Ju jetoni në Gjermani, vend në të cilin jetojnë shumë shqiptarë. Në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, sikur devijoi imazhi i shqiptarëve atje. A mendoni se tani ky imazh ka filluar të përmirësohet?**

▲ Kjo erdhi si rezultat i rrethanave në të cilat jetonin shqiptarët. Ndërsa tani, mund të them se shumë gjëra kanë ndryshuar, kuptohet për të mirë. Tani shqiptarët janë mirë të integruar në shoqëri. Lidhjet me vendlindjen janë të tjera, komunikimet po ashtu, dhe dalëngadalë po zhduket ajo ndjenjë e të jetuarit në mërgim, që ishte në dekadat e mëparshme. Tani shqiptarët nuk thonë më që janë kurbetçarë apo mërgimtarë, por që punojnë në Gjermani. Kjo mendoj erdhi si rezultat i ndryshimeve që ndodhën në vendlindjen tonë.

▼ **Ju pëlqen të udhëtoni?**



Blerim Destani: *Në orientimin tim kanë ndikuar aktorët Bekim Fehmiu dhe Marlon Brando, jam rritur me veprat e tyre*

Cilin vend e vizitoni më me dëshirë?

▲ Udhëtimi është një nga pasionet e mia. Më pëlqen shumë të udhëtoj, të vizitoj vende të reja dhe të takoj njerëz. Ka shumë vende që i vizitoj me shumë dëshirë, siç është vendlindja. Në këtë kontekst jam i privilegjuar pasi edhe çdo udhëtim për në Prishtinë unë e përjetoj si udhëtim për në vendlindje. Prishtina më pëlqen shumë, atje kam shumë miq, dhe çdo vizitë në

Prishtinë më mundëson që t'i mbush bateritë për të vazhduar më tej. Kuptohet, është edhe një qytet që tek unë e ka këtë vullë, ai është New Yorku, çdoherë kur e vizitoj këtë qytet magjik, më thellohet ndjenja që ai është disi kryeqyteti i gjithë botës. Thjesht, më mbush me shumë energji, i gjithë qyteti pulson me një ritëm të çuditshëm të cilin e përcjell tek ata që e vizitojnë. Kjo më bën të ndihem shumë mirë. ■